

Raporti monitorues i keqinformimit për muajin shtator

2024

tetor 2024

Action for
Democratic Society
hibrid.info



Raporti monitorues i keqinformimit për muajin shtator

Publikues: ADS/hibrid.info

Prishtinë, tetor 2024

© Të gjitha të drejtat janë të rezervuara nga ADS/hibrid.info. Të drejtat e pronës intelektuale mbrohen me Ligjin Nr. 04/L-065 për të Drejtat e Autorit dhe të Drejtat e Përafërta dhe me Ligjin Nr. 05/L-047 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr.04/L-065 për të Drejtat e Autorit dhe të Drejtat e Përafërta.

Asnjë pjesë e këtij botimi nuk mund të riprodhohet, të ruhet në sisteme elektronike apo të bartet, në çfarëdo forme apo me çfarëdo mjeti, qoftë mekanik, me fotokopje, incizim apo në mënyra të tjera, pa lejen paraprake me shkrim të botuesit

Ky raport është publikuar nga Action for Democratic Society (ADS) në kuadër të projektit “Promovimi i gazetarisë objektive dhe lufta kundër dezinformimit”, që mbështetet nga National Endowment for Democracy (NED).

Përmbajtja e dokumentit është përgjegjësi e ADS-së dhe në asnjë mënyrë nuk mund të konsiderohet se pasqyron qëndrimin e NED-it.

Projekti financohet nga:



Projekti realizohet nga:



Përmbajtja

01.

Publikimet në gjuhën shqipe

Kategoritë vlerësuese të çrregullimit informativ
Temat e përdorura për krijimin dhe shpërndarjen e përmbajtjeve keqinformuese
Llojet e fushave tematike
Llojet e publikuesve
Klasifikimi i publikimeve të mediave në gjuhën shqipe dhe serbe
Llojet e mediave sociale
Figurat dhe Institucionet më të përfolura

02.

Publikimet në gjuhën serbe

Kategoritë vlerësuese të çrregullimit informativ
Temat e përdorura për krijimin dhe shpërndarjen e përmbajtjeve keqinformuese
Llojet e fushave tematike
Llojet e publikuesve
Klasifikimi i publikimeve të mediave në gjuhën shqipe dhe serbe
Llojet e mediave sociale
Figurat dhe Institucionet më të përfolura

03.

Kontrulli dhe vlerësimi i deklaratave

Hyrje

Ky raport përmbledhës dhe përshkrues pasqyron gjendjen e informimit (keqinformimit) gjatë shtatorit 2024, bazuar në të dhënat e siguruara nga platforma për kontroll të fakteve – hibrid.info. Format i këtij raporti është i pari dhe i vetmi i llojit. Është monitorues dhe paraqet gjendjen për një periudhë njëmuajore, ndërsa ky është raporti i 24-të mujor i publikuar deri më tash.

Ky raport është i ideuar nga platforma hibrid.info e specializuar në kontroll të fakteve, edukim digjital dhe medial, pjesë e OJQ-së kosovare “Action for Democratic Society” (ADS) dhe mbështetet nga fondacioni amerikan “National Endowment for Democracy” (NED) në kuadër të projektit “Promovimi i Gazetarisë Objektive dhe Luftimit të Dezinformatës”.

Në këtë raport monitorues jepet një pasqyrë për formën e përmbajtjeve me karakter informues për dhe rreth ngjarjeve në Kosovë. Në vazhden e këtij raporti paraqiten disa figura (grafika) të dala nga baza e të dhënave të hibrid.info e ndarë përmes disa kategorive të vlerësimit që janë pjesë e metodologjisë për kontroll të fakteve të kësaj platforme.

Raporti trajton 8 kategori krahasuese të të dhënave, duke synuar të japë një sqarim më objektiv të gjendjes së informimit dhe për të shpjeguar tendencat e keqinformimit për këtë periudhë monitoruese.

Kategoritë monitoruese janë:


- Vlerësimet e artikujve keqinformues;
- Temat e përdorura për krijimin dhe shpërndarjen e përmbajtjeve keqinformuese;
- Fushat mbi të cilat janë krijuar dhe shpërndarë artikujt keqinformues;
- Llojet e mediave që kanë krijuar e shpërndarë përmbajtje keqinformuese;
- Kategorizimi i mediave në gjuhën shqipe dhe serbe që kanë krijuar e shpërndarë përmbajtje keqinformuese;
- Llojet e mediave sociale që kanë krijuar e shpërndarë përmbajtje keqinformuese;
- Llojet e publikuesve në mediat sociale që kanë krijuar e shpërndarë përmbajtje keqinformuese;
- Institucionet dhe personat e përfolur në artikujt keqinformues;
- Kontrolli dhe vlerësimi i deklaratave.

Përmbajtja e trajtuar nga hulumtuesit e hibrid.info, e që ka shërbyer për ndërtimin e këtij raporti, është kryesisht ajo e publikuar në gjuhën shqipe dhe serbe.

Klasifikimi i publikimeve në gjuhën shqipe dhe serbe (të tjera)

Kjo matje tregon se në cilën gjuhë janë publikuar artikujt keqinformues të monitoruar gjatë periudhës njëmuajore, duke i kategorizuar mediat në gjuhën shqipe, serbe dhe gjuhë të tjera në lidhje me raportimet e tyre për dhe rreth zhvillimeve në Kosovë.

PËRQINDJA E PUBLIKIMEVE NË GJUHËN SHQIPE DHE SERBE



Mostra e monitorimit dhe trajtimit të përmbajtjeve keqinformuese nga platforma “hibrid.info” fokusohet në keqinformimet në gjuhën shqipe, të publikuara në media, portale të dyshimta, si dhe faqe dhe llogari në mediat sociale.

Gjatë muajit shtator, në kuadër të monitorimit, janë trajtuar 63 përmbajtje, ku 58 (92%) prej tyre ishin në gjuhën shqipe ndërsa 4 (6%) në gjuhën serbe dhe angleze 1 (2%).

1

Publikimet në gjuhën shqipe

Gjatë analizës së përmbajtjeve keqinformuese në gjuhën shqipe për muajin shtator 2024, është evidentuar se 92% e 63 përmbajtjeve të identifikuara ishin në këtë gjuhë. Lajmet e rreme përbënin 27% të totalit, ndjekur nga mashtrimet dhe dezinformatat me nga 16%. Ndryshimet nga gushti në shtator tregojnë se lajmet e rreme ranë nga 31% në 27%, ndërsa clickbait u rrit nga 7% në 14%. Këto përmbajtje ishin kryesisht të shpërndara përmes mediave sociale si Facebook dhe TikTok, me pretendime të rreme mbi armatosjen e FSK-së dhe zhvillimet në veri.

Temat kryesore të përmbajtjeve keqinformuese ishin nga politika (37%), siguria (30%), dhe temat sociale (13%), me politikën që u rrit ndjeshëm nga 27% në 37% gjatë këtij muaji. Gjithashtu, 70% e përmbajtjeve keqinformuese ishin publikuar në mediat sociale, me TikTok që dominon me 35% dhe Facebook me 33%. Kjo tregon një kalim të rëndësishëm në preferencat e publikut për burimet e informacionit dhe rritjen e interesit të TikTok-ut për publikimin e keqinformatave.

Përqindja e përmbajtjeve në
gjuhën shqipe




Kategoritë vlerësuese të çrregullimit informativ

1.1

KATEGORITË KRYESORE

Këtu janë renditur kategoritë kryesore sipas kategorive vlerësuese



Në përputhje me gjetjet e analizës së 58 përmbajtjeve keqinformuese në gjuhën shqipe për muajin shtator 2024, është vërejtur se lajmet e rreme përbëjnë kategorinë më të shpeshtë të keqinformimit, duke zënë 27% të totalit. Pas tyre, përmbajtjet mashtrues dhe dezinformatat zënë vend më 16% secila, ndërsa clickbait dhe përmbajtjet e paverifikuar kapin 10%.

Në krahasimin midis gushtit dhe shtatorit, vihet re një ndryshim në shpërndarjen e kategorive të dezinformatave dhe lajmeve të rreme. Lajmet e rreme ishin kategoria më e përhapur në të dy muajt, por në gusht përfaqësonin 31% të rasteve, ndërsa në shtator u ulën në 27%. Clickbait u rrit ndjeshëm nga 7% në gusht në 14% në shtator, duke reflektuar një përdorim më të madh të titujve tërheqës dhe mashtrues.

Dezinformatat u trefishua, nga 6% në gusht në 16% në shtator, duke treguar një rritje të qëllimshme të përhapjes së informacionit të pasaktë. Kategoria e mashtrimit gjithashtu u rrit nga 6% në gusht në 16% në shtator, ndërsa përmbajtja e paverifikuar, e cila nuk ishte mesin e kategorive kryesore në gusht, përfaqësoi 10% të rasteve në shtator.



27% e artikujve keqinformues të trajtuar kanë marrë vlerësimin “lajm i rremë”.

1.1.1.

Analizë e llojeve të vlerësimeve

01. Lajm i rremë

Të gjitha lajmet e rreme janë shpërndarë përmes faqeve dhe llogarive në platforma të ndryshme sociale, si Facebook dhe TikTok. Fushat kryesore për të cilat u keqinformua më së shumti janë siguria (14%) dhe politika (10%). Armatosja e FSK-së (10%) dhe zhvillimet në veri (5%) janë dy temat kryesore për të cilat u publikuan lajme të rreme. U publikuan pretendime të rreme për armatosjen e FSK-së me artileri të rëndë si, mbrojtje raketore, tanke etj, si dhe ndërlidhur me veriun u publikuan pretendime të rreme se Qeveria Kurti do t'i ndërtojë mbi 600 shtëpi për shqiptarët në veri të Kosovës, për arrestime e konfiskim armësh në veri të vendit.

03. Dezinformatë

Dezinformatat janë publikuar në media sociale (13%) dhe media reale (3%). Këto dezinformata u publikuan për tema nga fusha e politikës (8%), sigurisë (5%) dhe sociale (3%). Dezinformatat u publikuan për tema të ndryshme si, investime në Kosovë, për komunitetin serb, rekrutimin në FSK, përkatësinë fetare etj.

02. Mashtrim

Pothuajse të gjitha përmbajtjet mashtruese (14%) janë publikuar në mediat sociale dhe përmes SMS-ve. Mashtrimet kanë mbuluar tematika sociale dhe politike, me një sërë çështjesh të vlerësuara si mashtruese. Në aspektin social, përmbajtjet përfshinin oferta për kurse falas, mundësi pune, çmime të biçikletave elektrike dhe rimbursime të faturave të energjisë. Ndër temat politike, u përhapën mashtrime lidhur me sondazhe zgjedhore, zgjedhjet në SHBA dhe të tjera. Përmes SMS-ve, qytetarët morën mesazhe mashtruese që pretendonin dorëzimin e një pakoje postare.

04. Clickbait

Përmbajtjet clickbait kryesisht janë publikuar në media reale. Temat nga kronika e zezë (8%) dhe politika kanë dominuar në këto përmbajtje. Lajme për vdekje, rrëmbime, shpërthime dhe gjetje të trupave të pajetë janë publikuar me tituj që nuk tregojnë qartë vendndodhjen e ngjarjeve. Nga fusha e politikës, janë publikuar tituj çorientues për hapjen e urës së lbrit dhe çështjen e Kosovës në lidhje me CEFTA-n.


Artikuj të tjerë me përmbajtje keqinformuese janë vlerësuar në kategoritë: Përmbajtje e paverifikuar, Mashtrim / Lajm i rremë, Clickbait / Dezinformatë, Përmbajtje e paverifikuar / Gabim, Përmbajtje e paverifikuar / Dezinformatë, Manipulim i fakteve

1.2

Temat e përdorura për krijimin dhe shpërndarjen e përmbajtjeve keqinformuese

KATEGORITË KRYESORE

Këtu janë renditur kategoritë kryesore sipas temave




Armatosja e FSK-së mbeti një temë e qëndrueshme në të dy muajt e fundit, duke përfaqësuar 13% të vëmendjes, pa ndryshim në përqindje nga gushti në shtator. Në gusht, Ura e Ibrit zuri 10% të diskutimeve, por në shtator kjo temë nuk u raportua më si e rëndësishme. Po ashtu, rasti i Faton Hajrizit, që zinte 4% të vëmendjes në gusht, nuk u përmend më në shtator.

Interesi për veriun e Kosovës u rrit nga 3% në gusht në 5% në shtator, duke treguar një fokus më të madh për këtë rajon në muajin e dytë. Zgjedhjet në Kosovë dhe çështja e Kamala Harris dhe Kosovës, që përfaqësonin secila nga 3% të temave në gusht, nuk u shfaqën më në shtator.

Në shtator, disa tema të reja u bënë të rëndësishme. Rastet tragjike përbënin 8% të diskutimeve, ndërsa çështje si sondazhet zgjedhore, gjuajtjet me armë në lagjen "Aktash", pasuria e politikanëve, dhe rimbursimi i faturave të energjisë elektrike zunë secila nga 3% të vëmendjes.

Në përmbljedhje, ndërsa armatosja e FSK-së mbeti një temë kryesore në të dy muajt, gushti kishte më shumë fokus në çështje të veçanta si Ura e Ibrit dhe zgjedhjet, ndërsa shtatori tregoi një rritje të interesit për ngjarje tragjike dhe çështje të sigurisë dhe politikës së brendshme.



31% e temave kryesore janë për armatosjen e FSK-së, raste tragjike, veriun, sondazhe zgjedhore.

Analizë e kontrolleve të fakteve sipas temave

1.2.1.

Në vijim analizohen, në formë të përmbledhur, katër temat kryesore të trajtuara nga media dhe publikues të ndryshëm, sipas matjeve të platformës hibrid.info, përmes metodologjisë së kontrollit të fakteve.

01. Armatosja e FSK-së

Të gjitha keqinformatat lidhur me armatosjen e FSK-së janë shpërndarë përmes platformave të mediave sociale, si Facebook dhe TikTok. Këto përmbajtje të pasakta nga fusha e sigurisë kryesisht janë klasifikuar si lajme të rreme. Ka disa pretendime të rreme lidhur me pajisjet ushtarake dhe sigurinë në Kosovë. Njëra nga këto është se përgatitjet për parakalimin ushtarak në Sllovaki paraqiten si pajisje që po vijnë nga Amerika në Kosovë. Po ashtu, nuk ka konfirmim se Kosova do të pajiset me automjetin e blinduar “Shota” dhe se ka siguruar tanke nga Turqia. Pretendohet gjithashtu se FSK-së i janë shtuar 60 tanke AVC-15, si dhe se Turqia do t’ia dhurojë Kosovës 5 pajisje ushtarake “Korhan”. Për më tepër, Kosova nuk ka blerë pajisjet ushtarake “KORKUT 8×8” nga Turqia, dhe një imazh i montuar sugjeron rrejshëm se Turqia do t’i dhurojë helikopter Kosovës.

02. Raste tragjike

Të gjitha përmbajtjet keqinformuese lidhur me raste tragjike janë publikuar në media. Këto keqinformatat janë vlerësuar si clickbait dhe përbëjnë tema të kronikës së zezë. Shumica titujve të këtyre përmbajtjeve nuk e sqarojnë qartë vendndodhjen e ngjarjeve. Për shembull, një titull që thotë “ngjarje shokuese” nuk përmend se incidenti ka ndodhur në Amerikë. Po ashtu, një titull si “e papritur” nuk tregon se ngjarja ka ndodhur në Këln, dhe as “Incident alarmant” nuk sqaron se ngjarja ndodhi në Iran. Një tjetër rast është “e pabesueshme”, ku as titulli e as fotografia nuk theksojnë vendin e ngjarjes. Madje, disa media e anashkalojnë të përmendin në titull tragjedinë e vdekjes së 17 nxënësve në një shkollë në Kenia.

03. Veriu

Keqinformatat për veriun janë publikuar në media sociale dhe janë vlerësuar si lajm i rremë. Këto keqinformata janë nga fusha e sigurisë dhe politika. Nga fusha e sigurisë, janë bërë pretendime të rreme për arrestime dhe konfiskim armësh në veri të vendit. Po ashtu, me pamje të vjetra, është pretenduar rrejshëm se ka snajperistë të Policisë së Kosovës në atë zonë. Nga fusha e politikës, është bërë një pretendim i rremë se Qeveria Kurti do të ndërtojë mbi 600 shtëpi për shqiptarët në veri të Kosovës.

03. Sondazhe zgjedhore


Pretendime të rreme për sondazhe zgjedhore janë publikuar nga faqe dhe llogari në media sociale (Facebook dhe Tiktok). Këto pretendime për sondazhe zgjedhore nga fusha e politikës janë vlerësuar si lajme të rreme, mashtrim/lajm i rremë dhe mashtrim. U bënë disa pretendime të rreme lidhur me temat e sondazheve. Një rast është kur Exit-Polli për zgjedhjet lokale të vitit 2017 në Ferizaj paraqitet rrejshëm si sondazh për zgjedhjet e vitit 2025. Po ashtu, u publikua një sondazh i rremë për zgjedhjet parlamentare, si dhe një sondazh i partive britanike që paraqitet rrejshëm si i partive të Kosovës.

1.3

Llojet e fushave

Si rezultat i gjetjeve të përmbajtjet keqinformuese të trajtuara gjatë muajit qershor del se publikues të ndryshëm (media reale dhe mediat sociale) kanë prodhuar dhe shpërndarë më së shumti përmbajtje keqinformuese në fushën e politikës.

FUSHAT KRYESORE
Këtu janë renditur 6-të fushat kryesore




Si rezultat i gjetjeve lidhur me përmbajtjet keqinformuese të trajtuara gjatë muajit shtator, rezulton se publikues të ndryshëm (media reale dhe media sociale) kanë prodhuar dhe shpërndarë kryesisht përmbajtje keqinformuese në fushën e politikës, e cila përbën 37% të totalit.

Në gusht, temat e sigurisë dhe politikës kishin një prani të barabartë, secila me 27%, duke reflektuar një interes të lartë për çështjet në këto fusha. Ndërsa temat sociale zinin 11% dhe ato të shëndetësisë vetëm 4%, me katastrofat natyrore që përbënin 3% të diskutimeve.

Në shtator, politika u rrit në 37%, duke u bërë tema kryesore për publikimin e keqinformatave. Siguria mbeti gjithashtu e rëndësishme, duke zënë 30%. Temat sociale u rritën në 13%, por ndikimi i shëndetësisë ra në 4%. Në këtë muaj, për herë të parë u përmendën edhe kronika e zezë me 8% dhe Gjykata Speciale me 2%.

Në përmbledhje, ndonëse politika dhe siguria mbeten tema të rëndësishme, shtatori tregon një rritje të dukshme të interesit për politikën, ndërsa temat e tjera si kronika e zezë zunë vend në temat kryesore.



80% e përmbajtjeve keqinformuese të trajtuara janë nga fusha e politikës, sigurisë dhe sociale.

Llojet e publikuesve

1.4



Duke u bazuar në analizat e përmbajtjeve keqinformuese në gjuhën shqipe, rezulton se keqinformatat nga faqet dhe llogaritë në mediat sociale vazhdojnë të jenë të pranishme në mënyrë të theksuar edhe gjatë muajit shtator.

Kur krahasojmë përqindjet e shpërndarjes së përmbajtjeve midis gushtit dhe shtatorit, vërehet një rritje e dukshme në përdorimin e mediave sociale.

Në gusht, media sociale përbënte 58% të përmbajtjeve, ndërsa media reale zinte 21%. Në shtator, media sociale shënoi një rritje të konsiderueshme, duke arritur në 70%, ndërsa media reale mbeti e qëndrueshme në 21%.

Ky trend tregon se në shtator, përdorimi i mediave sociale për shpërndarjen e përmbajtjeve ka vazhduar të rritet, duke reflektuar një praktikë të dukshme në preferencat e publikut për burimet e informacionit.

DALLIMI NË PËRQINDJE NË MES
TË PUBLIKUESVE ME
PËRMBAJTJE KEQINFORMUESE



70% e artikujve me përmbajtje keqinformuese janë publikuar nga publikuesit në media sociale

Llojet e mediave sociale


1.5

Në këtë seksion analizohen vetëm artikujt keqinformues të publikuar dhe shpërndarë nga publikuesit në mediat sociale dhe në këtë rast nuk përfshihen publikimet në mediat tjera (mediat reale dhe portalet e dyshimta).

Sipas monitorimit të realizuar në shtator, është vënë re se përmbajtjet keqinformuese në gjuhën shqipe janë shpërndarë gjerësisht në disa platforma sociale, me TikTokun që ka dominuar me 35%. Krahasuar me muajin gusht, kur Facebook ishte në krye me 31%, në shtator TikTok renditet si platforma e parë për shpërndarjen e këtyre përmbajtjeve.

Në gusht, Facebook kishte një prani prej 31%, ndërsa TikTok zinte 23%. Në shtator, situata ndryshoi, me TikTok që arriti një rritje të dukshme, duke shkuar në 35%. Ndërsa Facebook gjithashtu shënoi një rritje të vogël, duke arritur në 33%. Kjo tregon se TikTok ka fituar një avantazh të qartë mbi Facebook në shtator, me një diferencë prej 2% midis tyre, krahasuar me gushtin, kur Facebook kishte një avantazh prej 8% ndaj TikTok. Ky ndryshim tregon se audiencia po kalon gjithnjë e më shumë në TikTok për përmbajtje keqinformuese.

PËRQINDJA E PUBLIKIMEVE NË
MEDIAT SOCIALE




Llojet e publikuesve në mediat sociale

1.6

Kjo matje, përmes të dhënave monitoruese, analizon ndërveprimin në mediat sociale sa i përket publikimit dhe shpërndarjes së artikujve keqinformues nga publikues të ndryshëm të mediave sociale. Kjo bëhet përmes këtyre kategorive kryesore të publikuesve: faqeve, llogarive, mediave dhe kanaleve që menaxhohen nga përdorues të mediave sociale.

Tabela tregon shpërndarjen e përmbajtjeve në disa platforma sociale dhe lloje llogarish. TikTok dallohet si burimi kryesor, me 35% të përmbajtjeve që vijnë nga llogaritë e saj. Facebook renditet i dyti me 33% të përmbajtjeve, nga të cilat 30% vijnë nga faqet e ndryshme, ndërsa 2% janë nga llogaritë personale dhe 2% nga media.

Përveç kësaj, emaili kontribuon me 2% të përmbajtjeve, duke treguar një përdorim të vogël për shpërndarjen e informacionit. YouTube gjithashtu ka një prani të vogël, me 2% të përmbajtjeve, ku po ashtu përqindja nga media është 2%.



1.6.1.

Analiza e llojeve të publikuesve në mediat sociale

Në vijim analizohen këto kategori të mediave sociale në ndërlidhje me publikimet dhe shpërndarjen e përmbajtjeve keqinformuese

01. TikTok

Lajmet e rreme kanë dominuar në TikTok, duke përbërë 19% të përmbajtjeve. Dy fushat kryesore ku është shpërndarë keqinformimi në TikTok janë politika (19%) dhe siguria (14%). Sa i përket temave specifike, armatosja e FSK-së dhe sondazhet zgjedhore janë ato që kanë pasur më shumë përhapje.

02. Facebook


Në Facebook socialja (11%), siguria (10%) dhe politika (10%) janë tri fushat kryesore për të cilat u keqinformua më së shumti. Nga këto fusha dominojnë keqinformatat e vlerësuara si mashtrim (11%), dezinformatë (10%) dhe lajm i rremë (8%). Temat e përmbajtjeve përfshijnë armatosjen e FSK-së (5%), rimbursimin e faturave elektrike (3%), pronat e financuara nga Serbia, mundësitë e punës, tërmetet, çmimet e biçikletave elektrike, zgjedhjet në SHBA, deklaratat e Clinton për politikanët kosovarë, përkatësinë fetare, gjuajtjet me armë zjarri në lagjen “Aktash” etj.

Figurat dhe institucionet më të përfolura

1.7.

Kjo matje analizon të dhënat se cilat kanë qenë institucionet dhe personalitetet (figura publike e politike) më të përfolura përmes monitorimit të artikujve me përmbajtje keqinformuese.

RENDITJA E INSTITUCIONEVE MË TË PËRFOLURA SIPAS PËRQINDJES




FSK-ja përmendet në 8 përmbajtje keqinformuese që trajtojnë pretendime të pasakta mbi situatën ushtarake dhe furnizimet me pajisje ushtarake. Një pretendim i rremë sugjeron se përgatitjet për parakalimin ushtarak në Sllovaki interpretohen si dërgesa pajisjesh që po vijnë nga Amerika në Kosovë. Po ashtu, ka thashetheme të pabaza se Kosova do të pajiset me automjetin e blinduar shqiptar “Shota” dhe se ka siguruar tanke nga Turqia, ndonëse nuk ka konfirmim për këto informacione. Më tej, raportohet se FSK-ja ka bërë thirrje për t’u bashkuar me ushtrinë për të gjithë qytetarët mbi 18 vjeç, si dhe se i janë shtuar 60 tanke AVC-15. Po ashtu, pretendohet pa fakte se Turqia do t’i dhurojë Kosovës pesë pajisje ushtarake “Korhan” dhe se Kosova ka blerë pajisje ushtarake me sistem të mbrojtjes ajrore “KORKUT 8×8” nga Turqia. Në fund, një tjetër pretendim i rremë përmes një imazhi të montuar që sugjeron se Turqia do t’i dhurojë Kosovës helikopterë.

Policia e Kosovës përmendet në disa përmbajtje keqinformuese lidhur me situatën në veri. Një pretendim i rremë sugjeron se ka pasur arrestime dhe konfiskim armësh në këtë zonë. Po ashtu, është përhapur një pamje e vjetër që pretendon se snajperistët e Policisë janë të pranishëm në veri. Gjithashtu, ka informacione të pasakta që armët e shkatërruara nga policia ishin pronë e serbëve, duke përhapur dezinformata lidhur me veprimtaritë e policisë.

Institucionet e tjera të përfolura përfshijnë Postën e Kosovës, Ministrinë e Financave, Punës dhe Transfereve (MFPT), Qeverinë, CEFTA-n, si dhe partitë politike PDK, LDK, AAK, LVV dhe NISMA.

RENDITJA E PERSONAVE MË TË PËRFOLUR SIPAS PËRQINDJES



Albin Kurti është figura më e përfolur në përmbajtjet keqinformuese të publikuara në gjuhën shqipe gjatë muajit shtator 2024, përfshirë edhe me personalitete të tjera.

Albin Kurti është përfolur në lidhje me disa tema keqinformuese, përfshirë pretendimin e rremë se Qeveria Kurti do të ndërtojë mbi 600 shtëpi për shqiptarët në veri të Kosovës. Po ashtu, është shpërndarë informatë e pasaktë se ai ka deklaruar se Kosova po planifikon hapjen e një fabrike të armatimit. Gjithashtu, ka pretendime të rreme që thonë se Kosova ka blerë nga Turqia pajisjet ushtarake me sistem të mbrojtjes ajrore “KORKUT 8×8”.

Kurti është përfolur në lidhje me ministrin e jashtëm të Turqisë, Hakan Fidan, duke përfshirë një pretendim të rremë që sugjeron se përmes një imazhi të montuar, Turqia do t’i dhurojë Kosovës helikopterë. Albin Kurti është përfolur gjithashtu për një pretendim se ai është takuar fshehurazi në Beograd me peshkopin Teodosije, i dioqezës së Rashkës dhe Prizrenit.

Albin Kurti është përfolur në lidhje me presidentin e Turqisë, Recep Tayyip Erdogan, për një pretendim të rremë që thotë se Kosova ka siguruar tanke nga Turqia. Po ashtu, ai është përmendur me Princin e Kuvajtit në një pretendim tjetër të pasaktë, që sugjeron se Kuvajti do t’i investojë mbi 1 miliardë euro në Kosovë.


2.

Publikimet në gjuhën serbe

Gjatë analizës së 65 përmbajtjeve keqinformuese, 4 prej tyre (6%) u identifikuan si të publikuara në gjuhën serbe.

Kategoritë e vlerësimit tregojnë se teoritë konspirative dominonin me 8%, të ndjekura nga dezinformatat me 7% dhe lajmet e rreme me 3%. Ka pasur keqinformata që janë vlerësuar si teori konspirative, përmbajtje e paverifikuar, dezinformatë dhe manipulim i fakteve.

KATEGORITË KRYESORE
Këtu janë renditur kategoritë kryesore sipas kategorive vlerësuese



Në bazë të gjetjeve dhe trajtimit të katër përmbajtjeve keqinformuese gjatë muajit shtator 2024, është evidentuar se kanë ekzistuar keqinformata që janë vlerësuar si teori konspirative, përmbajtje e paverifikuar, dezinformatë dhe manipulim i fakteve.

Teori konspirative u vlerësua pretendimi se sulmi ndaj një serbi u krye nga shqipfolës për

motive etnike, si pasojë e politikave të Kurtit. Kjo paraqet një teori konspirative, e cila është mbështetur nga mediat në gjuhën serbe, të cilat publikuan njoftimin e Zyrës për Kosovën në Qeverinë e Serbisë rreth një ngjarjeje në fshatin Grackë të Lipjanit, ku një person i komunitetit serb u rrah dhe grabit.


Pretendimi i paverifikuar se serbët e arrestuar në veri janë keqtrajtuar gjatë arrestimit të katër personave në mesnatën e 10 shtatorit është bërë pa ndonjë verifikim të faktit, duke lënë hapur mundësinë e manipulimit të informacionit.

Dezinformata kishte të bënte me pretendimin se një qytetar serb në Mitrovicë ishte dënua me 500 euro pasi inqizoi arrestimin e disa të rinjve serbë dhe se policët i kishin marrë telefonin dhe ia kishin fshirë pamjet, një informacion ky i paqartë dhe i paverifikuar.

Manipulimi i fakteve kishte të bënte me pretendimin e disa mediave në gjuhën serbe se një personazh në Zvicër, me emrin Sanija Ameti, kishte prejardhje nga Kosova, një informacion ky që nuk ishte i verifikuar.

KATEGORITË KRYESORE


Këtu janë renditur kategoritë kryesore sipas temave



Në analizën e përmbajtjeve keqinformuese, është evidentuar se përqindjet e shënjestrimit janë si në vijim: Veriu ka përfaqësuar 3% të përmbajtjeve, ndërsa shënjestrimi i fotografisë së Shën Mërisë dhe Krishtit bebe ka kontribuar me 2%. Po ashtu, vendbanimet me shumicë serbe janë identifikuar gjithashtu me 2%,

FUSHAT KRYESORE

Këtu janë renditur 6-të fushat kryesore




Në analizën e përmbajtjeve keqinformuese, është vërejtur se fusha e sigurisë ka përfaqësuar 5% të të gjithë përmbajtjeve, ndërsa politika ka kontribuar me 2%. Këto përqindje tregojnë se çështjet e sigurisë janë përqendruar më shumë në sferën e keqinformimit, krahasuar me ato politike.


Në përmbledhjen e përmbajtjeve keqinformuese, është evidentuar se mediat reale kanë përfaqësuar 5% të totalit të përmbajtjeve, ndërsa mediat sociale kanë kontribuar me 2%. Këto shifra sugjerojnë se mediat reale janë burimi kryesor i informacionit, përkundrajt mediave sociale, të cilat luajnë një rol më të vogël në shpërndarjen e përmbajtjeve të tilla.

Në mediat sociale, Telegram kontribuon me nga 2% secila, duke vazhduar të jenë burime të përhapjes së keqinformimit.

DALLIMI NË PËRQINDJE NË MES TË PUBLIKUESVE ME PËRMBAJTJE KEQINFORMUESE



RENDITJA E INSTITUCIONEVE MË TË PËRFOLURA SIPAS PËRQINDJES



Nga 4 keqinformata të identifikuara gjatë muajit shtator 2024, në 3 prej tyre janë përmendur institucione të rëndësishme.


Dy institucionet e përfolura janë Policia e Kosovës dhe Zyra për Kosovën në Qeverinë serbe. Policia e Kosovës është përfolur në lidhje me pretendimet pa fakte se i ka marrë telefonin dhe i ka fshirë incizimet një qytetari serb, si dhe për pretendimin e pa verifikuar se serbët e arrestuar në veri janë keqtrajtuar.

Zyra për Kosovën në Qeverinë serbe është përmendur në pretendimin pa fakte se, sulmi ndaj një serbi u krye nga shqipfolës për motive etnike, duke e lidhur këtë ngjarje me politikat e kryeministrit Albin Kurti.

Gjatë muajit shtator 2024, personalitetet më të përmendura në përmbajtjet keqinformuese ishin kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, i cili u përmend në 2 raste.

Albin Kurti është përmendur në pretendimin pa fakte se, sulmi ndaj një serbi u krye nga shqipfolës për motive etnike, duke e lidhur këtë ngjarje me politikat e tij. Po ashtu, ai është i përfshirë në pretendimin e paverifikuar se serbët e arrestuar në veri janë keqtrajtuar.

RENDITJA E PERSONAVE MË TË PËRFOLUR SIPAS PËRQINDJES




3.

Kontrolli dhe vlerësimi i deklaratave

Hibrid.info, përveç kontrollit dhe analizës së artikujve mediatik, bën edhe kontrollin dhe vlerësimin e deklaratave të zyrtarëve të lartë politikë e institucionalë, si dhe figurave që kanë ndikim publik. Vlerësimi i këtyre figurave, sipas metodologjisë së hibrid.info, bëhet në kategoritë e vërtetësisë, qëndrueshmërisë dhe përmbajtjes së premtimeve.

RENDITJA E KONTROLLIT DHE VLERËSIMIT TË DEKLARATAVE



Në kuadër të përmbajtjes së monitoruar gjatë muajit shtator, hibrid.info ka kontrolluar dhe analizuar 2 deklarata.

Spitali i Prishtinës ishte premtuar gjatë mandatit të kryetarit të Komunës së Prishtinës, Përparim Rama. I njëjti ishte thënë se do të bëhej në një objekt të ri apo do të shfrytëzohej hapësira e QKUK-së. Më 23 qershor të vitit 2022, ishte prezantuar plani i fizibilitetit për Spitalin e Përgjithshëm të Prishtinës nga Komuna e Prishtinës. Ndërsa në një postim të 1 shtatorit të po atij viti, Përparim Rama, kryetari i Komunës së Prishtinës, njoftonte se kishte vizituar lokacionin e dedikuar për ndërtimin e objektit të Spitalit të Kryeqytetit. Rama tregonte se pritet që ndërtimi i objektit të fillojë gjatë vitit 2023. Dy vite nga ky njoftim i kryetarit Rama ndërtimi i këtij objekti nuk ka nisur, megjithë paralajmërimet për fillimin e ndërtimit të tij edhe brenda vitit 2024.

Pesë shtëpi për kujdesin ndaj të moshuarve ishin premtuar në fushatën e zgjedhjeve të jashtëzakonshme të 14 shkurtit, në vitin 2021, nga Lëvizja Vetëvendosje (LVV). Premtimi u dha nga kandidati për kryeministër i këtij subjekti politik, Albin Kurti, madje u përfshi në programin qeverisës, pasi LVV siguroi shumicën për të marrë drejtimin e vendit. Zgjedhjet e rregullta për Kuvendin e Kosovës do të mbahen më 9 shkurt të vitit të ardhshëm. Çka do të thotë se qeverisja aktuale është afër përfundimit të mandatit. Në bazë të kërkimeve, hibrid.info ka gjetur se ndërtimi i pesë shtëpive për kujdesin ndaj të moshuarve ende nuk ka filluar gjatë këtij mandati.

Metodologjia

Për hartimin e këtij raporti monitorues janë përdorur metodat kuantitative dhe ato kualitative.

Sa i përket metodave kuantitative, fillimisht është krijuar baza e të dhënave nga ADS/hibrid.info me qëllim të zbërthimit dhe analizimit të detajuar të trendëve të keqinformimit. Përmes kësaj baze të të dhënave, e cila mirëmbahet dhe përditësohet në baza të rregullta ditore nga stafi i ADS/hibrid.info, monitorohen rregullisht artikujt me përmbajtje keqinformuese.

Kjo nënkupton se të gjithë artikujt e publikuar në platformën hibrid.info vendosen në bazën e të dhënave dhe kjo e fundit shërben si një ndër burimet kryesore për përgatitjen e raportit monitorues. Për më tepër, metodologjia e përdorur për analizimin e të dhënave të paraqitura në raportin monitorues bën të mundur filtrimin e të dhënave në baza ditore, javore e mujore, dhe atë në formë kryesisht kuantitative, për të kuptuar më qartë fenomenin e keqinformimit të atyre artikujve të analizuar për këtë periudhë monitoruese një mujore sipas kategorive e vlerësimeve të ndryshme.

Krahas kësaj, një burim tjetër i rëndësishëm për këtë raport është metodologjia e ADS/hibrid.info (e publikuar në faqen e hibrid.info) për luftën kundër çrregullimit informativ. Metodologjia, e cila është e bazuar para së gjithash në metodat kualitative, është hartuar nga stafi profesional i ADS/hibrid.info dhe është në harmoni me standardet më të larta ndërkombëtare për kontroll të fakteve, gjegjësisht sipas udhëzimeve të Rrjetit Ndërkombëtar për Kontroll të Fakteve (IFCN). ADS/hibrid.info është anëtarë me të drejta të plota në këtë mekanizëm ndërkombëtar - IFCN.

Ky raport monitorues përfshin periudhën nga 1 deri më 30 shtator 2024, në të cilën janë trajtuar 63 përmbajtje keqinformuese.

Përfundime

Ky raport i shkurtër monitorues paraqet një pasqyrë të gjendjes njëmuajore të informimit (keqinformimit) gjatë muajit shtator 2024, nga të dhënat e platformës për kontroll të fakteve – hibrid.info.

Gjatë muajit shtator 2024, analizat e përmbajtjeve keqinformuese në gjuhën shqipe kanë treguar se 92% e 63 përmbajtjeve të identifikuara ishin në këtë gjuhë. Kategori kryesore e keqinformimit ishin lajmet e rreme, që përbënin 27% të totalit, ndjekur nga mashtrimet dhe dezinformatat, secila me 16%. Ndryshimet mes gushtit dhe shtatorit tregojnë se lajmet e rreme ishin më të përhapura në të dy muajt, por përqindja e tyre ra nga 31% në 27%, ndërsa clickbait u rrit nga 7% në 14%, duke reflektuar një përdorim më të madh të titujve tërheqës, dhe dezinformatat u trefishuan nga 6% në 16%.

Analiza thekson se lajmet e rreme ishin shpërndarë kryesisht përmes mediave sociale si Facebook dhe TikTok, duke përfshirë pretendime të rreme mbi armatosjen e FSK-së dhe zhvillimet në veri. Kategori të tjera të përmbajtjeve mashtruese përfshinin oferta për kurse falas dhe sondazhe zgjedhore, ndërsa dezinformatat u publikuan mbi tema si investimet në Kosovë dhe rekrutimin në FSK. Interesi për veriun e Kosovës u rrit, dhe përmbajtjet keqinformuese lidhur me rastet tragjike shënuan një rritje të dukshme në krahasim me gushtin.

Në shtator, temat kryesore për përmbajtjet keqinformuese ishin politika (37%), siguria (30%), dhe temat sociale (13%), me politikat që shënuan rritje nga 27% në gusht në 37% në shtator. Po ashtu, në këtë muaj, 70% e përmbajtjeve keqinformuese ishin publikuar në mediat sociale, me TikTok që dominoi me 35%, duke kaluar Facebook-un që kishte 33%. Ky ndryshim tregon një praktikë të rëndësishme në preferencat e publikut për burimet e informacionit.

Gjatë analizës së 6 përmbajtjeve keqinformuese, 4 prej tyre (6%) u identifikuan si të publikuara në gjuhën serbe. Në bazë të gjetjeve dhe trajtimit të katër përmbajtjeve keqinformuese gjatë muajit shtator 2024, janë evidentuar keqinformata të klasifikuara si teori konspirative, përmbajtje e paverifikuar, dezinformatë dhe manipulim i fakteve. Një shembull i teorisë konspirative është pretendimi se sulmi ndaj një serbi u krye nga shqipfolës për motive etnike si pasojë e politikave të Kurtit, ndërsa pretendimi se serbët e arrestuar në veri janë keqtrajtuar gjatë arrestimit, është bërë pa verifikim të faktit.

Në aspektin e fushave, temat e sigurisë përbënin 11% të përmbajtjeve keqinformuese, duke theksuar rëndësinë e tyre në kontekstin aktual, ndërsa politika kishte një peshë prej 7%. Media reale kontribuoi me 11% të përmbajtjeve të identifikuara si keqinformuese, ndërsa media sociale zuri 6%, duke e theksuar rolin e saj në shpërndarjen e informacionit të pasaktë. Personalitetet dhe institucionet më të përmendura ishin kryeministri Albin Kurti dhe Zyra për Kosovën në Qeverinë serbe, të cilat u përmendën në keqinformata dhe në teoritë konspirative që qarkullojnë në mediat serbe.

Në analizën e përmbajtjeve keqinformuese, tema e sigurisë përfaqësoi 5% të përmbajtjeve, ndërsa politika kontribuoi me 2%. Mediat reale ishin burimi kryesor i informacionit, me 5% të totalit të përmbajtjeve, krahasuar me 2% nga mediat sociale. Gjatë këtij muaji, dy institucionet më të përfolura ishin Policia e Kosovës dhe Zyra për Kosovën në Qeverinë serbe, me pretendime lidhur me keqtrajtimin e serbëve dhe sulme ndaj shqiptarëve. Personaliteti më i përfolur ishte Albin Kurti, i cili u përmend në lidhje me politikën e tij dhe pretendimet e rreme që lidhen me veprimet e Policisë.

Gjatë muajit shtator, u monitoruan dy deklaratatë të rëndësishme: premtimi për ndërtimin e Spitalit të Përgjithshëm të Prishtinës nga kryetari i Komunës, Përparim Rama, dhe ndërtimi i pesë shtëpive për kujdesin ndaj të moshuarve nga kryeministri Albin Kurti. Megjithëse Rama kishte premtuar fillimin e ndërtimit në vitin 2023, ky projekt ende nuk ka nisur. Po ashtu, premtimi i Kurtit për shtëpitë e kujdesit për të moshuarit, i dhënë gjatë fushatës zgjedhore të vitit 2021, nuk ka avancuar, duke treguar se qeverisja aktuale po i afrohet përfundimit të mandatit pa realizimin e këtij premtimi.

HIBRIDO.INFO